



Tel:

E-Mail: info@ishmt.gov.al

Web-site: www.ishmt.gov.al

Proçedura e Regjistrimit të Ashensorit pranë ISHMT-së

Faqe 1 nga 5

Procedura e Regjistrimit të Ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së

Zbatues: Kryeinspektori, Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve, Sektori i Produkteve Mekanike

Përgjegjës për zbatimin: Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve

QËLLIMI

Qëllimi kësaj procedure është që të vendosë rregulla dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të drejtë rrugën që ndiqet për regjistrimin për herë të parë të Ashensorit pranë ISHMT-së nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) dhe pajisjes të Personit Përgjegjës me Çertifikatën e Regjistrimit .

1) FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet vetëm kur regjistrohet për herë të parë ashensori dhe hartohet çertifikata.

2) PËRGJEGJËSITË

Sektori i Produkteve Mekanike dhe Drejtori i Mbikëqyrjes së Produkteve janë përgjegjës për zbatimin e kësaj procedure.

3) REFERIMET

- Ligji nr.10489 Ligji Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”
- VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”;
- VKM Nr. 192, datë 04.04.2018, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara””;
- VKM nr. 643 datë 02.10.2019 “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e ashensorëve në përdorim’”;
- VKM nr 36 , datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut”.

4) RREGULLAT E REGJISTRIMIT TË ASHENSORËVE PËR HERË TË PARË PRANË ISHMT-SË

Ashensorët ekzistues¹

Referuar Nenit 16 të Ligjit Nr.10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” datë, pikës 4.1, të VKM nr.1056 VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, dokumentat që duhet të dorëzohen nga subjektet për regjistrimin e ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së duhet të përfshijnë: a) Formularin e regjistrimit të plotësuar; b) Kopje të Raportit të Ekzaminimit të parë të plotë të ashensorit ekzistues.

Ashensorët e rinj²

Referuar pikës 4.1. të VKM nr.1056 VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, dokumentat që duhet të dorëzohen nga subjektet për regjistrimin e ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së duhet të përfshijnë: a) Formularin e regjistrimit të plotësuar; b) Kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.

Dokumentat e dorëzuar nga subjekti shoqërohen me një kërkesë (format i unifikuar për të gjithë) për regjistrim ashnsori/ët. Dokumentat verifikohen nga grupi i inspektorëve të Sektorit të produkteve mekanike dhe përpilohet një Memo, që pas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit të Produkteve Mekanike, i dorëzohet Drejtorit të DMP. Drejtori i DMP i dërgon Kryeinspektorit kërkesën për miratimin për pajisjen me çertifikatë të regjistrimit të ashensorit për subjektin/personin përgjegjës që ka bërë aplikimin. Çertifikata e Regjistrimit të Ashensorit hartohet brenda një periudhe kohore jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e protokollimit të kërkesës për regjistrim pranë ISHMT-së.

5) FORMULARI I REGJISTRIMIT

Formulari i regjistrimit është përpiluar në përputhje me pikat e përcaktuara në Piken 4.2 të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e

¹ Në bazë të pikës 1/a të VKM nr. 643 datë 02.10.2019 “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e ashensorëve në përdorim’”, “**Ashensor ekzistues**” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim përpara datës 31 dhjetor 2019.

² Në bazë të pikës 1/a të VKM nr. 643 datë 02.10.2019 “ Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e ashensorëve në përdorim’”, “Ashensor i ri” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim, duke filluar që prej datës 1 janar 2020 .

ashensorëve në përdorim”, miratuar me Urdhër të Kryeinspektorit. Formularin e Regjistrimit çdo subjekt/person përgjegjës mund ta shkarkojë nga web-site i ISHMT-së: www.ishmt.gov.al ose mund ta gjejë pranë zyrave të ISHMT-së.

6) ÇERTIFIKATA E REGJISTRIMIT

Në modelin e unifikuar të çertifikatës pasqyrohen:

1. Logo dhe adresa e ISHMT;
2. Numri unik i regjistrimit të ashensorit (me 6 shifra 000000) i shoqëruar me inicialin e shkurtur të emrit të bashkisë (shembull TR 000015)
3. Data efektive e dhënies së Çertifikatës
4. Numri serial i ashensorit të regjistruar;
5. Vendndodhja e ashensorit (adresa e specifikuar me detaje);
6. Marka e ashensorit;
7. Qëllimi i përdorimit;
8. Personi Përgjegjës
9. NIPT
10. Numri i identifikimit të Organit të Miratuar (OM);
11. Lloji i ekzaminimit.

Me çertifikatë regjistrimi do të pajisen vetëm ashensorët që i janë nënshtruar një ekzaminimi të plotë fillestar nga një organ i miratur.

1) REGJISTRIMET

Regjistrimet që dalin nga kjo procedurë janë

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
Çertifikata e regjistrimit të ashensorit	Sektori i produkteve mekanike/DMP	Pasi merret vendimi për regjistrimin	Protokolli

2) HISTORIKU

Data e Ripunimit	Numri i Ripunimit	Autori	Përshkrimi i ndryshimeve të bëra
------------------	-------------------	--------	----------------------------------



Tel:

E-Mail: info@ishmt.gov.al

Web-site: www.ishmt.gov.al

**Proçedura e Regjistrimit të Ashensorit pranë
ISHMT-së**

Faqe 5 nga 5

25.04.2023		Grupi punës , Urdhëri nr.101 datë 24.04.2023, nr.prot.1342	Varianti fillestar